



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivruy	13. 04 2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
\$KAMSHUK	2081/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.185/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.185/2022 të datës 28.02.2022 të parashtruar nga _____ me adresë banim _____ kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në punë për vitin 2021, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.185/2022 e datës 28.02.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Ndryshohet Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për vitin 2021 i datës 31.01.2022, lidhur me notën e përgjithshme nga mjaftueshëm (2.4) në notën mirë (3).
- III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Punës si në pikën 2 të dispozitivit dhe i njëjti të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunësit civil.
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Gjilanit, që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ nëpunës civil në Komunën e Gjilanit, më datë 28.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1034/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2021, për shkak të vlerësimit jo të drejt dhe real të rezultateve në puna, dhe shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.03.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjilanit. Këshilli, me datë 15.03.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1034/2022 të datës 28.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 28.02.2022 nga ankuesi; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesme, Ulet dhe Profesionale për vitin 2021 për ankuesin përmes SIMBNJ datë 31.01.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punës i datës 30.11.2021; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punës për vitin 2018 (mars-prill) i datës 31.12.2018; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punës për vitin 2018 (maj-dhjetor) i datës 31.12.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.03.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 15.03.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar Juridik; Akt Emërimit me Nr. 02-16-25860 të datës 09.03.2012; Kërkesë për prova shtesë e datës 21.03.2022; Përgjigje në provë shtesë e datës 24.03.2022; Vendimin me numër 02Nr.1000 i datës 03.12.2021 nga Kryetari i Komunës së Gjilanit; Vendimin me numër 02Nr.62 i datës 31.01.2022 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit; Emailin e datës 28.03.2022 nga B.A; Emailin e datës 25.03.2022 nga ankuesi lidhur me raportet javore të kërkuara sipas kërkesës për prova shtesë e datës 21.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas Akt Emërimit me numër 02-16-25863 të datës 09.03.2012 ankuesi është i punësuar në pozitën Zyrtar Juridik në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Mbrojtje dhe Mjedis të Komunës së Gjilanit.

Me tej Kolegji nga shkresat e lëndës ka gjetur se lidhur me Vlerësimin e Rezultateve të Punës për vitin 2020 ankuesi ka dy Formularë të vlerësimit dhe atë formulari i datës 30.11.2021 ku nota e përgjithshme është 3.96, dhe Formulari i SIMBNJ i datës 31.01.2022 ku nota e përgjithshme është 2.4, ndërsa sipas kërkesës së Këshillit, organi i punësimit ka njoftuar se vlerësimi i saktë është ai i SIMBNJ.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ka analizuar nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe*

vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimitarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.. dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar), rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi sipas të cilës konstatohet se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me ankuesin kanë përcaktuar objektivat e punës në fillim të vitit 2021 konkretisht ankuesi nuk posedon plan individual të punës për vitin 2021. Po ashtu nga shkresat e lëndës Kolegji nuk ka arritur të vërtetoj faktin së ankuesit i janë dhënë detyra të punës dhe së i njëjti nuk i ka përmbushur ato, apo që ndaj të njëjtit ka pas vërejtje nga eprori i tij lidhur me sjelljen jo profesionale apo mos realizimin e detyrave të punës. Andaj, mbi këto arsye Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson që vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin me notë të përgjithshme 2.4 pa pasur plan konkret të objektivave dhe pa menaxhim të vazhdueshëm të performances se ankuesit në përmbushje të objektivave të punës, është vlerësim jo real dhe jo i bazuar në fakte dhe argumente të mjaftueshme, dhe mbi këtë bazë rezultojnë së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Nisur si me lartë, si dhe duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se:... 4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit), Kolegji ka ndryshuar Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2021, për ankuesin ashtu që nota e përgjithshme përfundimtare 2.4 ndryshohet me notën e përgjithshme përfundimtare tre (3), e që në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafin 2 nënparagrafin 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nota nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton vlerësimin "mirë".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për

Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.185/2022

Avdyl BEKTESHI

Bekteshi
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

